



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Nr. 1315/2.Prot.

Berat, më 07/03/2019

Lënda : Kërkesë për publikim, shtesa në Planin vjetor të Pranimi në Shërbimin Civil

Drejtuar : SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT ,TIRANË

Në zbatim të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar ,neni 18 si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.108 datë 26.02.2014 “Për planin Vjetor të Pranimi në Shërbimin Civil”, bashkëlidhur po ju dërgojmë për publikim shtesa në planin Vjetor të Pranimi në Shërbimin Civil të Bashkisë Berat për vitin 2019 .

Faleminderit për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin.

KRYETARI I BASHKISË

Petrit SINAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Nr. 1315 / Prot.

Berat, më 07/03/2019

V E N D I M

Nr. 206 datë 07/03/2019

PËR

SHTESA NË PLANIN VJETOR TË PRANIMIT PËR VITIN 2019, NË
INSTITUCIONIN E BASHKISË BERAT PJESË E SHËRBIMIT CIVIL

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, neni 8 ,pika 2, neni 9 ,gërma b, të nenit 18 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin Civil”, I ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 108 , datë 26.02.2014”Për planin vjetor të pranimit në Shërbimin Civil”, Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Berat nr.925 Prot, datë 26.11.2018 “Miratimi i strukturës së Bashkisë Berat për vitin 2019”, i ndryshuar, informacionit të Njesisë Përgjegjëse të datës 07.03.2019 “Për pozicionet e lira të krijuara nga ristrukturimi dhe dorëheqja e nëpunësve civil “, Kryetari i Bashkisë

V E N D O S I:

1.Numri i vendeve vakante që i shtohen planit vjetor të pranimit në shërbimin civil , në administratën e Bashkisë Berat, pjesë e shërbimit civil do të jetë 4(katër)gjithsej sipas kategorive të mëposhtëme:

a)Për kategorinë ekzekutive shtohen 4(katër)pozicione.

2.Grupet e administrimit të përgjithshëm në kategorinë ekzekutive janë si më poshtë :

Shkenca/ Inxhierike/Pyjore /Mjedisore/Agronomi

Shkenca Shoqërore /Teknologji Informacioni /Komunikimi/politike

3.Drejtoritë ku planifikohen të shtohen vendet vakante janë :

Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Marrdhënieve me Publikun dhe Juridike

Drejtoria e Emergjencave Civile, Shërbimeve Publike dhe Pronave

4.Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore ,Marrdhënieve me Publikun dhe Juridike, në cilësinë e njesisë përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.

5.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË

Petrit SINAJ

